



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 363/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Xhevdet Abazi kryesues, Muhamet Rexha dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkizazi me ankesën e Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega në Rahovec, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Rahovec, për shkak të vendosjes së banerit mbi rrugë publike, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 31.10.2013, mori këtë:

VENDIM

Miratohet si e bazuar ankesa e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), dega në Rahovec, kështu që subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Rahovec, i shqiptohet dënimini me gjobë në vlerë prej 1550 (njëmijë e pesëqind e pesëdhjetë) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 28.10.2013, nga LVV, me të cilën pretendohet se me datën 26.10.2013, në fshatin Ratkoc dhe fshatin Radoste komuna e Rahovecit anëtarë të subjektit politik PDK, kanë vendosur banerë të kandidatit për kryetar komune Idriz Vehapi mbi rrugë publike. Parashtuesi i ankesës me këtë rast konsideron se është bëre shkelje e Nenit 33 pika b) e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme LZP, dhe nenit 4.1 pika b) e Rregullës Zgjedhore Nr.11/2013.

PZAP-i, e informoi subjektin politik PDK në kuptim të Nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, më datë 28.10.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar të përgjigjet deri më datë 29.10.2013. Sipas afatit të caktuar, PZAP-i pranoi përgjigjen në ankesë nga subjekti politik PDK, në të cilën theksohet se pretendimet e LVV, janë të pabaza, lidhur me shkeljen e rregullave të përcaktuara me nenin 33 pika b të LZP-së ose nenit 3 pika b të Kodit të mirësjelljes së subjekteve politik. Poashtu në përgjigjen në ankesë PDK, thekson se persona të pëaidentifikuar kanë vendosur banerë të kandidatit për Kryetar Komune në Rahovec, Idriz Vehapi, nga radhët subjektit politik PDK, dhe e kanë vendosur në vendet jo të lejuara me qëllim për të dëmtuar Partinë Demokratike, ndërsa me të kuptuar këtë aktivistet e PDK-së, kanë shkuar në vendin e caktuar dhe e kanë hequr banerin e kandidatit. Në cilësinë e provës i kanë bashkangjitur përgjigjigjetësë së ankesës një fotografi nga vendi i shkeljes së supozuar.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Nga fotografitë e bashkangjitura si provë të cilat gjenden në shkresat e lëndës shihet qartë se baneri i kandidatit për kryetar të komunës së Rahovecit, Idriz Vehapi i subjektit politik të PDK-së, është i vendosur mbi rrugë publike , që është në kundërshtim me nenin 4.1 pika b) të Rregullës Zgjedhore 11/2013 dhe nenin 33 pika b) të LZP-së e cila përcakton veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, që ndalojnë vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugë publike.

Për përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi PZAP-i, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

PZAP-i, mori parasysh të gjitha rrethanat si rënduese ashtu edhe rrethanat lehtësuese. Si rrethanë rënduese mori se, subjekti politik PDK, ka marr pjesë edhe në zgjedhjet e kaluar dhe se konsiderohet se është e njoftuar me procesin zgjedhor dhe faktin se posteri i kandidatit të PDK-së, për Kryetar të Komunës së Rahovecit, ka qenë i vendosur në vendin e palejuar për vendosjen e posterave si dhe atë se subjekti i njëjtë politik ka bërë shkeljes të njëjtës natyre edhe më parë në këto zgjedhje. Ndërsa si rrethanë lehtësuese PZAP-i, mori se subjekti politik PDK, pas marrjes së kërkësës për përgjigjes në ankesë nga PZAP-i, brenda afatit të caktuar, ka ndërmarr veprime të dukshme për evitimën e shkeljes, duke i larguar menjëherë banerët nga vendi ku pretendohet se ka ndodhur shkelja e supozuar.

PZAP-i, duke marr parasysh të gjitha arsyet e lartcekura konstatoi se subjekti politik PDK-ka rënë në kundërshtim me nenin 4 paragrafi 1 pika "b" të Rregullës Zgjedhore Nr. 11/2013 dhe nenin 33 pika b) të LZP-së, pasi që baneri i kandidatit për kryetar komune, të PDK-së, është i vendosur mbi rrugë publike , që është ndaluar me dispozitat e cituara më lart, për lartësinë e gjobës së shqiptuar ka ndikuar veprimet menjëhershme të subjektit politik PDK-së, për evitimën e shkeljes së supozuar si dhe përpjekjet për të parandaluar veprimet e ndaluara në bazë të provave të cilat i ka ofruar të bashkangjitura përgjigjes në ankesë andaj në kuptim te, nenit 120 paragrafi 1 pika c), si dhe nenit 118.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesë dhe Parashresa në Prishtinë

Anr. 363/2013 më datën 31.10.2013.

**Kryesuesi i Panelit
Xhevdet Abazi**

Këshillë Juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkësat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatë (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.